



UNIVERSITETI I TETOVËS  
UNIVERSITY OF TETOVA - УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО  
U.T. Rectorate - Ilinden piri, 1200 Tetovë, Macedonia  
Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222; email: international@uutte.edu.mk

UT - Fakulteti Ekonomik - Republika e Maqedonisë së Veriut  
УТ - Економски факултет - Република Северна Македонија

Nr.-Bp. 14-386

16.06 2020 viti/год.

Tetovë - Тетово

## FAKULTETI EKONOMIK

### Studimet e Doktoraturës

Drejtimi: Ekonomi e Aplikuar

### RAPORTI I MENTORIT

#### PËR VLERËSIMIN E DISERTACIONIT TË DOKTORATURËS TË KANDIDATËS- SHPRESA BAJRAMI

Kandidatja-Doktorante **Shpresa Bajrami** që nga momenti i fillimit të studimeve të doktoraturës në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tetovës, viti akademik-2015/2016, me sukses i ka përbushur të gjitha obligimet e definuara në këtë program studimor të ciklit të tretë- Ekonomi e Aplikuar, e që kanë të bëjnë me dhënien e provimeve përkatëse, realizimin e aktiviteteve nëpër konferencat e ndryshme doktorale në kuadër të Fakultetit Ekonomik, përmes publikimeve përkatëse nëpër Revistat e ndryshme ndërkombëtare që përbushin kriteretet obligative në nivel të studimeve të doktoraturës si dhe aktivitete tjera dhe të ndryshme profesionale dhe shkencore etj.

Gjitha këto momente si dhe puna e sajë shumëvjeçare, duke filluar së pari me angazhimet e saja si mësimdhënëse në Universitetin Publik "Hasan Prishtina"- Prishtinë prej vitit- 2008 e deri në vitin 2012.

Prej vitit akademik-2013 e deri në vitin 2015, kandidatja-Shpresa Bajrami vazhdon me ambicjet e saja në sferën e arsimit të lartë dhe angazhimet e veta i vazhdon në "Universitetin Publik të Gjilanit", ku me shumë suksese realizon procesin mësimor-shkencor.

Në vazhdimësi të aktiviteteve të saja në sferën e arsimit të lartë, kandidatja-doktorante prej vitit akademik 2015 e deri në vitin 2018, ka qenë e angazhuar në "Universitetin Publik të Shkencave të Zbatuara" në Ferizaj, pas të cilit vit akademik angazhimet e veta profesionale-shkencore i vazhdon në Universitetin-AAB në Prishtinë si dhe në dispersimet tjera.

Kandidatja -Doktorante Shpresa Bajrami, aktivitete të frytshme ka realizuar edhe në sferën e trajnimeve të ndryshme profesionale, nga edhe ka pasuruar përvojën e sajë profesionale-shkencore dhe në bazë të përvojës shumëvjeçare të fituar nga angazhimet e pandërprera në sferën e arsimit të lartë, si dhe në bazë të interesimeve si dhe njohurive të fituara nga pjesa e studimeve permanente, ka përcaktuar, ka koncipuar dhe definuar temën e punimit me titull **“Roli ekonomik i NVM-ve nëpër komunat si parakusht për zhvillimin e përshpejtuar socio-ekonomik të Republikës së Kosovës”**.

Sa i përket pjesës së punimit të doktoraturës, kandidatja-doktorante Shpresa Bajrami, në mënyrë aktive, duke bashkëpunuar dhe konsultuar si me mentorin, poashtu, edhe me të gjithë ata që kanë patur njohuri nga kjo sferë të punimit, me qëllim që të sigurojë të dhëna të ndryshme kualitative të karakterit primar dhe sekondar, në funksion të koncipimit, përgatitjes dhe të përfundimit të temës së disertacionit të doktoraturës, ka përcjellë dhe zbatuar parakushtet e nevojshme në punim në mënyrë që t,i plotësojë standardet e nevojshme për një punim kualitativ në nivel të doktoraturës.

Në këtë drejtim, kandidatja ka theksuar në punimin e saj të doktoraturës se masat e ndryshme të përkrahjeve institucionale, si në nivel të Qeverive lokale ashtu edhe në nivel Qendror, kanë qenë të destinuara në drejtim të shtimit permanent të numrit të NVM-ve nëpër njësitë e Vetëqeverisjes lokale, që u treguan si bartës kryesor të zhvillimeve të përshpejtuara socio-ekonomike të këtyre shteteve të zhvilluara;

Prandaj, në esencë, nga ana e kandidatës, në këtë drejtim është parashtruar “çështja” e korelacionit në mes numrit të subjekteve afariste dhe numrit të banorëve të një Komune, si parakusht për potencialet shoqërore-ekonomike me të cilat disponon ajo njësi lokale;

Kuptohet se nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë zhvillim të përshpejtuar ekonomik të Komunave dhe, në përgjithësi të shtetit, nëse nuk merren në konsideratë format e përkrahjeve të ndryshme institucionale për realizimin e inisiativave të ndryshme biznese nga ana e Sipërmarrësve të rinj Kosovar.

Në këtë funksion është theksuar fakti që Institucionet Kosovare, përmes adaptimit permanent të Legjislativës dhe aplikimit të formave të ndryshme të përkrahjes së bizneseve, krijojnë kushte të volitëshme biznese duke mundësuar një ambient real kompetitiv që karakterizon një “ekonomi të tregut të lirë”.

Në kuadër të të gjitha këtyre aktiviteteve institucionale që realizohen në R e Kosovës me qëllim që përpjekjet e saja institucionale të jenë në përputhje me politikat përkatëse të BE-së, gjegjësisht me "Aktin e Biznesit të Vogël (Small Business Act (SBA)) dhe kornizën e BE-së për “Progresin e Konkurrencës dhe të Inovacioneve (EU

framework progress Competitiveness and Innovation (CIP) në funksion për të arritur një balancë të përparësive të kësaj rritjeje të shpejtë të sektorit privat nëpër komunat përkatëse dhe zhvillimit të barabartë socio-ekonomik në Kosovë.

Prandaj, edhe në kuadër të objektivave të këtij punimi të doktoraturës, ndër orientimet kryesore të kandidatës është që të ofrojë një analizë kritike në lidhje me numrin e NVM-ve, rolin afarist dhe kontributin e sektorit të subjekteve të vogla afariste në proceset e zhvillimeve shoqërore-ekonomike të “Njësive të Vetadministrimit Lokal” (Komunat) në R e Kosovës. Në mesin e objektivave tjera, paraqitet edhe çështja e “varëshmërisë së numrit të NVM-ve nga potencialet demografike të komunës përkatëse, që paraqitet si faktor korelativ për zhvillimin ekonomik të vendit.

Në këtë kontekst, në mesin e objektivave tjera paraqitet edhe dimensionin e formave të ndryshme të përkrahjeve institucionale për themelimin, funksionimin dhe zhvillimin e suksesshëm të subjekteve afariste, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror, që reflektojnë potencialet përkatëse të zhvillimit të përshtetshëm ekonomik të vendit.

Përndryshe hulumtimi në fjalë ka konfirmuar supozimin se “numri i bizneseve në një Komunë” është parakusht për potencialet socio-ekonomike me të cilat disponon ajo njësi lokale, si dhe supozimin se “numri i subjekteve afariste” paraqitet si faktor i zhvillimit “jo të barabartë” socio-ekonomik i njësive të vetadministrimit lokal.

Nga aspekti teoriko-shkencor disertacioni paraqet një hulumtim të karakterit gjithëpërfshirës, duke e patur parasysh faktin se përfshinë një problematikë me përfitime pozitive funksionale-që është rezultat i aspektit kuantitativ dhe kualitativ nga ekzistimi dhe funksionimi i NVM-ve si qeliza bazë të prodhimit shoqëror.

Nga aspekti praktik, hulumtimi paraqet një punim i cili ka identifikuar dhe konfirmuar masat më efektive nga praktika më e suksesshme e vendeve më të zhvilluara ekonomike në mënyrë që, institucionet përkatëse qeveritare, si në nivelin të pushtetit lokal ashtu edhe në nivelin qendror, në bazë të specifikave të veta socio-ekonomike, në mënyrë shumë pragmatike dhe efektive duke i aplikuar format e ndryshme për themelimin, zhvillimin dhe funksionimin produktiv të NVM-ve do të mundin të shënojnë rezultate të fuqishme dhe të përshtetshme afariste drejt zhvillimit të ekonomisë Kosovare.

Kuptohet, në kuadër të këtij punimi janë përdorë metoda të ndryshme shkencore me qëllim të një analize më të thellësishme në funksion të nxjerrjes së konkluzave të arsyetuara shkencore

Në këtë kontekst, analizat përkatëse të hulumtimit janë realizuarë përmes aplikimit të metodave të ndryshme shkencore siqë janë-ato deskriptive, të analizës dhe të sintezës përmes së cilave janë konfirmuarë karakteristikat dhe specifikat e dukurive që janë objektivat e këtij hulumtimi, metoda historike, e cila, poashtu, ka aplikim të gjerë, nga aspekti i përdorimit të të dhënave sekondare, përmes së cilës janë përfiturarë përgjigje të pyetjeve të ndryshme lidhur me temën e përfshirë në punimin e doktoratës, metoda e komparacionit, në funksion të krahasimit të avantazheve dhe disavantazheve të nocioneve dhe dukurive të analizuara, pastaj, metoda induktive, deduktive, metoda statistikore etj.

Me aktin e zbatimit të këtyre metodave të ndryshme në punim, duhet theksuar edhe faktin që kandidatja duke konsultuar edhe literaturën përkatëse profesionale-shkencore ka tanguar tematikën e zgjedhur në mënyrë kausale, përmes një analize kritike të dukurive përkatëse socio-ekonomike, prej nga janë huazuarë informacione të ndryshme, sipas vlefshmërisë së tyre kualitative të autorëve të ndryshëm të huaj dhe vendor, si dhe subjekteve tjera institucionale që preokupojnë çështjen e kërkimit. Gjykimet bazohen në kombinimin e të dhënave, fakteve dhe ngjarjeve që kanë ndodhur dhe opinionëve kryesisht të bazuara në supozime dhe hipoteza.

Në këtë drejtim metodat e ndryshme sipërmendura kualitative dhe kuantitative, janë bazuar mbi të dhënat e marra nga Zyra Statistikore e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Banka Botërore, Agjensi të ndryshme, Regjistri Qendror etj., si dhe duke përdorur literaturë vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim që të realizohet testimi i hipotezave të parashtruara që, në formë sublimative, nga ana e kandidatës-doktorante janë definuar këto:

H1-“Numri i bizneseve në një Komunë reflekton potencialet socio-ekonomike të asaj njësie lokale”;

H2-“Numri i bizneseve në një Komunë është në korespondim me numrin e banorëve të asaj njësie lokale”;

H3-“Numri i ndryshëm i bizneseve sipas Komunave paraqitet si “faktor i zhvillimit jo të barabartë socio-ekonomik” të viseve të ndryshme në R e Kosovës”;

H4-“Dinamika e “Themelimit të bizneseve” brenda viteve të analizuara (2010-2015) konfirmon aplikimin e masave efikase socio-ekonomike nga ana e institucioneve përkatëse si në “nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror”;

H5-“Zhvillimi i përshpejtuar socio-ekonomik në bazë të numrit adekuat të NVM-ve në nivel lokal “është parakusht” për zhvillim të përshpejtuar të ekonomisë në nivel kombëtar”;

Në vazhdim të Raportit, kandidatja-doktorante Shpresa Bajrami ka marrë pjesë në disa konferenca tematike për problematikën në fjalë e sidomos në realizimin e disa punimeve me karakter ndërkombëtar dhe kriteret e definuara për publikimin e këtyre punimeve (në përputhje me rregullativat ligjore në këtë sferë të arsimit të lartë), të cilët punime kanë orientimet hulumtuese-shkencore me temën e definuar të doktoraturës.

Aktivitetet e pandërprera në sferat profesionale dhe shkencore vazhdojnë të jenë motivacionet kryesore të kandidatës, angazhimet permanente të cilat i ka realizuar përmes pjesëmarrjes nëpër konferenca të ndryshme ndërkombëtare siqë janë:

- “The Opportunities of the Foreigner Investments in Kosovo” The International Institute for Science, Technology and Education (IISTE) ;

- “The Impact of Human Resources Management in SMEs on the Republic of Kosovo“-The International Institute for Science, Technology and Education (IISTE);

- “Metodologjia dhe mesimdhënia nga TIK-u“ – book published in collaboration with Xhevdet Thaqi, Prishtine, 2010;

- “Information System and Technology Innovations: the New Paradigm for a Smarter Economy” 7<sup>th</sup> international conference in the Department of Statistics and Applied Informatics Faculty of Economy in the University of Tirana in collaboration with Academy of Science of Albania University of Business and Technology, Kosovo, 2016;

- “Information System and Technology Innovations: Fostering the As-A-Service Economy“ 8<sup>th</sup> international Conferences in the Department of Department of Statistics and Applied Informatics Faculty of Economy in the University of Tirana 2017 ;

- “The economic sustainability of Balkan Countries and the Euro-Integration challenges“ international scientific conference, AAB College in partnership with Universities of Durrës, Macedonia, Kroacia, Ulqin, 2018;

Kandidatja për Doktoraturë në vazhdimësinë e aktiviteteve të saja në sferën profesionale, në opusin e saj të begatshëm, ka realizuar edhe shumë aktivitete në formë të trajnimeve të ndryshme siqë janë:

- Trajnimi lidhur me “Të dhënat Statistike”-mbajtur më 31.01.2010, Fakulteti Ekonomi, Universiteti i Prishtinës;

- Trajnimi në Fakultetin e Edukimit lidhur me “Metodologjinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies” që është mbajtur më 21.03.2012, Universiteti i Prishtinës;

-Trajnim me temën” Shkathtësitë personale dhe Kompetencat”-mbajtur më 21.05. 2013, Kosovo Youth Development Project, Resource Hub, Universiti i Prishtinës;

Përndryshe, sikur që është theksuar edhe më lartë, në kuadër të obligimeve hulumtuese-shkencore që kanë të bëjnë me aspektin e realizimit të aktiviteteve permanente në sferën e zgjedhur, kandidatja-doktorante ka realizuar dhe ka publikuar edhe 2-punime relevante për temën e definuar të doktoraturës dhe që kanë këto përkufizime:

**1. Punimi i Parë “Citizens’ perceptions on the role of sme’s in local economic development of municipalities in the republic of Kosovo”.**

International Journal of Scientific & Engineering Research [www.iiser.org](http://www.iiser.org),  
December-2019, Volume 10, Issue 12, ISSN: 2229-5518, 865- 867,  
<https://www.ijser.org/onlineResearchPaperViewer.aspx?CITIZENS-PERCEPTIONS-ON-THE-ROLE-OF-SMES-IN-LOCAL-ECONOMIC-DEVELOPMENT-OF-MUNICIPALITIES-IN-THE-REPUBLIC-OF-KOSOVO.pdf>;

**2. Punimi i Dytë “The role of advertising in small business development and learning and economic development in Kosovo”-International Journal of Scientific & Engineering Research [www.iiser.org](http://www.iiser.org),**

December-2019, Volume 10, Issue 12, ISSN: 2229-5518, 1742-1744,  
<https://www.ijser.org/onlineResearchPaperViewer.aspx?The-role-of-advertising-in-small-business-development-and-learning-and-economic-development-in-Kosovo.pdf>;

Përndryshe, koncipimi i punimit është realizuar në 7 -kaptina dhe nënkaptina përkatëse, si dhe pjesa e hyrjes, përfundimit me sugjerime si dhe literaturës së shfrytëzuar, kuptohet, në një renditje logjike dhe kausale. Përndryshe, kandidatja e doktoraturës-Shpresa Bajrami, në funksion të zbatimit dhe koncipimit sa më të qartë, në punimin e saj të doktoraturës ka përdorë gjithësej- 29 tabela, 6-figura dhe 42-fusnota, instrumente këta të punimit, që vetëm konfirmojnë përmbajtjen kualitative të këtij punimi të disertacionit të doktoraturës.

Përmbajtja e përfshirë në punim e doktoraturës ka këtë strukturim:

Në fillim të punimit, kuptohet, është përfshirë pjesa e “**Hyrjes**”, që trajton çështjet e ndryshme lidhur me aktualitetin e temës së definuar dhe të hulumtuar, lënda dhe detyrat e hulumtimit, si dhe “hipotezat e parashtruara”.

Në këtë kontekst, në kuadër të kësajë pjese, kandidatja, ka bërë një vështrim deskriptiv mbi subjektet e vogla afariste (NVM-të), që paraqesin segmentin më vital, më fleksibil dhe më propulsiv të prodhimit shoqëror dhe të shërbimeve dhe, mund të ekzistojnë dhe të zhvillohen vetëm në një ambient specifik shoqëror dhe ekonomik. Kjo nënkupton funksionimin e suksesshëm të subjekteve të theksuara afariste në një ambient tipik të ekonomisë së tregut që është krejtësisht i liberalizuar dhe në bazë të pronës private dhe, që është më e rëndësishme, në një ambient me përkrahje të ndryshme institucionale.

Nga ana e kandidatës, është apostrofuar se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë “karakterin propulsiv”, që donë të thotë se paraqesin “faktorët tërheqës”(lokomotivë) të ekonomisë së gjithmbarshme kombëtare për shkak se mundësojnë hapjen e vendeve të reja të punës, sigurojnë mjete buxhetore, në bazë të “Subkontraktimit” kryejnë shërbime të ndryshme ndërmarrjeve më të mëdha, pasurojnë ofertën në treg me produkte dhe shërbime të ndryshme, fuqizojnë pozicionin e eksportit etj.

Sa i përket çështjes së potencialeve socio-ekonomike të Republikës së Kosovës, është përmendur faktori kryesor të biznesit--njeriu(sipërmarrësi) që nënkupton numrin e banorëve, i cili potencial sillet rreth 2 milionë, prej së cilës bazë, si popullësi aktive paraqiten rreth 1.200.000, prej të cilit potencial punues, për çdo vit në tregun e punës hyjnë rreth 30.000 punëkërkuesë dhe, për shkak të faktorëve të ndryshëm kufizuesë, mesatarisht arrijnë të punësohen përafërsisht 6.000-8.000-punëtorë. Kuptohet, shumica e bizneseve të regjistruara janë mikro-ndërmarrje (1 – 9 punëtorë), po ashtu edhe numri më i madh i të punësuarve është në këtë kategori të ndërmarrjeve, ku sipas numrit të punëtorëve të regjistruar në ARBK në këtë kategori janë 171393 punëtorë .

Nga aspekti i mundësive dhe potencialet socio-ekonomike të komunave Kosovare, është theksuar faktin që, edhe sikur nëpër vendet tjera të tranzicionit, edhe këtu paraqitet dimensionin socio-ekonomik i pabarazisë regjionale, që ende më shumë vjen në shprehje me integrimin e ekonomive nacionale në tregun botëror, e njëjta (pabarazia) midis komunave nuk zvogëlohet, por, ndodh e kundërta.

**Kapitina e parë** - është dedikuar “ **Aspekteve teorike e NVM-ve dhe dimensionet e tyre socio-ekonomikë**”, duke bërë një rekapitulim të mundësive të ndryshme

realizimit të inisiativave biznesore nga ana e sipërmarrësve të rinj, duke i analizuar definicionet ekzistuese për subjektet e vogla afariste, si në vendet anëtare të BE-së, ashtu edhe në Kosovë, në bazë të legjislativës ekzistuese që është në harmonizim me legjislativën e vendeve të BE-së., natyra specifike e NVM-ve dhe prirjet dhe orientimet e tyre në biznes etj. Në kuadër të kësajë kaptine janë analizuar edhe potencialet e ndryshme socio-ekonomike si dhe epërsitë biznesore të këtyre subjekteve të vogla afariste në krahasim me subjektet e mëdha, me mundësitë e pakufizuara që të kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë vendore, me të gjitha sfidat dhe implikimet e formave përkatëse menaxhuese., format legale të organizimit të këtyre subjekteve, roli socio-ekonomik dhe sipërmarrës i biznesit të vogël në ekonominë e përgjithshme kombëtare, duke i theksuar, në veçanti, sferat ekonomike e veprimit të ndërmarrjeve të vogla dhe vetitë e tyre specifike afariste etj. Kjo çështje të preferimit të sipërmarrësve të rinj Kosovar në drejtim të realizimit të bizneseve të reja, është një moment shumë i rëndësishëm që prejudikon orientimin e bizneseve, më tepër në fillim, në sferën e Tregtisë, Shërbimeve dhe më pak në degët e prodhimtarisë.

**Kapitina e dytë “Parakushtet afariste për startim me biznes të vogël”** ka përfshirë çështje të ndryshme lidhur me mundësitë e fillimit (startimit) me biznes të vogël, gjegjësisht, rrugët e mundshme si dhe sfidat për realizimin e inisiativave të ndryshme biznesore, problematika e lokacionit me të gjitha sfidat përcjellëse socio-ekonomike, avantazhet dhe disavantazhet që përcjellin NVM-të, dimensionin e planifikimit, llojet e bizneseve dhe situata aktuale e mundësive për startim me biznes etj. Është theksuar se, nga ky aspekt, edhe në Kosovë, kushtet për realizimin e inisiativave biznesore vazhdimisht përmirësohen.

Sikur që është elaboruar, planet afatgjatë strategjike të Kosovës janë drejtuar në mënyrë të qartë në përputhje me Aktin Evropian të Biznesit të Vogël. Në fakt Kosova është duke ndjekur direktivat e BE-se dhe rregulloret në sektorin e NVM-ve që nga viti 2002. Në të vërtetë strategjia e NVM-ve e Kosovës është konsideruar si një mjet për BE-në për të sjellë zhvillim ekonomik për të mirën e Kosovës. Duke thënë kështu, pika e parë e qëllimit të strategjisë së NVM-ve, e tëra i kushtohet për forcimin e kornizës legjislative dhe rregullative për krijimin dhe zhvillimin e NVM-ve, si dhe lehtësimin e qasjes në financa për NVM-të.



**Kapitina e tretë “Vështrim mbi sektorin e NVM-ve në Kosovë”** përfshinë çështje që kanë të bëjnë me dhënien e një pasqyre reale të “Sektorit të NVM-ve në Kosovë, karakteristikat e mjedisit biznesor si dhe kriteret për definimin e ambientit biznesor në Kosovë (Treguesit e Bankës Botërore të të Bërit Biznes, kornizat ligjore për themelimin dhe funksionimin e NVM-ve, proceset reformuese të ekonomisë Kosovare në bazë të “Aktit Evropian për Biznese të Vogla”, potencialet dhe kontributi i tyre nga aspekte të ndryshme mbi zhvillimin e ekonomisë kombëtare, pozicioni i NVM-ve përballë Sektorit Joformal, analiza e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë mbi Sektorin e NVM-ve, Agjensitë e ndryshme për përkrahjen e inisiativave të ndryshme biznesore, faktorë shtytës për koordinimin dhe stimulimin e politikave

Sa i përket çështjes së ekzistimit të barrierave të ndryshme me të cilat ballafaqohen subjektet e vogla afariste në ekonominë kombëtare të Kosovës, kandidatja ka potencuar faktin që edhe në Raportet e shumta të Progresit të ekonomisë së Kosovës, të përgatitura nga ana e KE-së për Kosovën 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, janë potencuar disa çështje (pengesa) në mesin e të cilave si kryesorë janë identifikuar tri barrierat, me të cilat përballen bizneset në Kosovë. Barriera e parë ka të bëjë me çështjen e furnizimit jo të qëndrueshëm me energji elektrike dhe me ujë, sidomos sfida të cilat janë posaçërisht serioze për NVM-të në sferën e prodhimit. Poashtu, si një prej barrierave përcjellëse kryesore për zhvillim të shpejtë të NVM-ve është identifikuar edhe “çështja e qasjes së kufizuar në tregun e financave. Në vazhdim, si barriera e tretë, është sundimi i pamjaftueshëm i ligjit, të cilin moment e ndajnë të gjithë qytetarët e Kosovës.

**Kapitina e katërt “Strategjitë kombëtare për përkrahjen institucionale të NVM-ve”** përfshinë çështje të ndryshme lidhur me vështrimin mbi situatën e tanishme ekonomike në Kosovë dhe rrethinë, format dhe masat institucionale për përkrahjen e NVM-ve si dhe strategjitë efikase për mbështetjen e NVM-ve të Kosovës, duke u nisur nga praktika e suksesshme të ekonomive më të zhvilluara në botë, por edhe në vendet e tranzicionit, duke i analizuar mundësitë e kapaciteteve institucionale që janë në funksion të përkrahjes dhe të ndihmës, përmes formave të ndryshme të NVM-ve në Kosovë, mundësitë në qasjen e financave, ligjet aktuale dhe mjedisi rregullator në funksion të shtimit të numrit, zhvillimit, ekzistimit të institucioneve financiare për nxitjen e NVM-ve me rëndësi për rritjen e ekonomisë vendore, indikatorët e ndryshëm ekonomik në funksion të rritjes dhe zhvillimit afarist të sektorit privat, ditët e biznesit të vogël, fushat e industrisë dhe politikat industriale të konkurrueshmërisë, mundësitë e partneritetit publiko-privat, treguesit e Bankës Botërore të “Të Bërit Biznes” (Doing Business), relacioni afarist i NVM-ve dhe sektori joformal-etj.

**Kapitina e pestë “ Çështja e Konkurentshmërisë së NVMve vendore dhe Kultura Sipërmarrëse”** përfshinë një vështrim të NVM-ve në Kosovë nga aspekte të ndryshme si që janë- mundësitë nga ngritja permanente të kapaciteteve biznesore të NVM-ve përmes masave dhe përkrahjeve të ndryshme institucionale me qëllim të ngritjes së aftësive konkurrabile të subjekteve vendore, sidomos, nga aspekti i kapaciteteve të tyre eksportuese, pozita dhe mundësitë e pjesëmarrjes të barabartë të femrës-sipërmarrëse në aktivitetet biznesore, dialogu dhe partneriteti publiko-privat, Shërbimet e ndryshme financiare dhe jofinanciare për përforsimin e aftësive konkurruese të NV-ve si dhe shërbimet për mbështetjen e biznesit, prezantimi i disa rasteve nga praktikatat më të suksesshme ndërkombëtare në politikën e mbështetjes së Biznesit Fillestar -Rasti i Kroacisë, Gjermanisë, dimensionit socio-ekonomik i kulturës sipërmarrëse, çështja e zhvillimit të kulturës sipërmarrëse tek sipërmarrësit e rinj, promovimi dhe Zhvillimi i Kulturës Ndërmarrëse në ekonominë e Kosovës, sipërmarrësia në SHBA-të si komponentë imperative të zhvillimit ekonomik, rasti i modeleve ekonomike të vendeve të ashtuquajtura “Tigrat ekonomike të Azisë Lindore”, rasti specifik i ekonomisë së Republikës Popullore të Kinës etj.

**Në kapitullin e gjashtë “Pozicioni i NVM-ve në Kosovë në Periudhën e pasluftës”** është bërë një rekapitulim në mes gjendjes socio-ekonomike dhe të kapaciteteve afariste në mes dy periudhave Kosovare, duke i krahasuar numrat e përgjithshëm të bizneseve në kohën e para luftës dhe numrin dhe potencialet socio-ekonomike të Kosovës së sotme, kur kanë filluar të paraqiten Sipërmarrës të rinj, që kanë mundësuar zhvillimin e fuqishëm socio-ekonomik të vendit në bazë të ekzistimit të mbi 50.000-biznese private.

Në punim është përmendur fakti që edhe në ekonominë e re Kosovare, struktura e bizneseve të realizuara ka qenë, në mënyrë të ngjashme, sikur edhe nëpër ekonomitë e vendeve të zhvilluara. Kjo nënkupton faktin që pjesa dërmuese e bizneseve të porsafilluara kanë patur orientimin e tyre në degën e tregtisë, për arsytet e njohura afariste që manifeston kjo degë të ekonomisë, kështu që kërkesat më të mëdha për kredi janë shënuar nga tregtia (53.9%) .

Autorja e punimit, në vazhdim, është bazuar në situatën e atëhershme, ku shumica e ndërmarrjeve (60 %) i takonin të ashtuquajturave mikrondërmarrjeve që kanë patur 1 - 9 punëtorë, 38. % u takojnë ndërmarrjeve të vogla, që kanë 10 – 49 punëtorë dhe 2.0 % u takojnë ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, që kanë 50 – 249 dhe mbi 249-të punësuarë. Nga këto të dhëna është konstatuar se ekonomia e Kosovës bazohet mbi themelimin dhe afarizmin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, që në përgjithësi përbëjnë afro 98 % nga gjitha subjekte afariste.

Në kaptinën e shtatë “ **Rezultatet nga Analiza dhe Komparacioni i të dhënave statistikore për NVM-të nëpër Komunitet Kosovare për periudhën e analizuar-2010-2015**” në mënyrë sublimative, janë përfshirë temat nga kaptinat më lartë të theksuara, që paraqesin thelbin e studimit dhe hulumtimit të punimit të doktoraturës së kandidatës-Shpresa Bajrami, për arsye se në këtë pjesë janë prezantuar të dhëna statistikore të siguruara nga institucione të ndryshme që tangoen me problematikën e “grumbullimit, renditjes, përpunimit dhe të ruajtjes së të dhënave për bizneset në Republikën e Kosovës, të cilat ishin bazë statistikore për realizimin e këtij hulumtimi të doktoratës.

Kandidatja, ka theksuar qasjen se në numrin e ndërmarrjeve aktive nuk janë përfshirë numri i ndërmarrjeve që kanë deklaruar me “0”(zero qarkullim dhe zero të punësuar) ndërsa në vitet paraprake të njejtat janë përfshirë

Në analizat e realizuara janë shfrytëzuar të dhëna të ndryshme për ndërmarrjet që i takojnë këtyre aktiviteteve ekonomike si: industri nxjerrëse (miniera, gurthyes dhe seperacione të zhavorrit), industri përpunuese (prodhimi), furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar, furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës, ndërtim, tregti, hotele dhe restorante, transport dhe magazinim, informacion dhe komunikim si dhe shërbime tjera biznesore.

Poashtu, është theksuar në punim se në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve nuk bëjnë pjesë ndërmarrjet që i takojnë këtyre sektorëve: bujqësia, gjuetia dhe pylltaria, peshkimi, financat, administrata publike, arsimit, shëndetësia dhe aktivitetet e ekonomive familjare për arsye metodologjise përkatëse statistikore.

Në funksion të prezantimit më të kuptueshëm, më elaborativ dhe më ilustrativ, është prezantuar edhe “Përmbajtja e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike”.

Në fakt, përmes kësaj “Nomenklature të Veprimtarive Ekonomike”, sikur nëpër institucionet e ndryshme statistikore të vendeve anëtare të BE-së ashtu edhe në vendet që synojnë të aderohen nëpër këto struktura Euro-Atlantike (siqë është Kosova), qëllimi kryesor është që të mundësohet krahasimin i të dhënave në nivel

ndërkombëtar, duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikat strukturore dhe Sistemin Evropian për llogaritë kombëtare.

Në bazë të analizave të deritanishme të potencialeve socio-ekonomike me të cilat disponojnë “Njësitë e Vetadministrimit Lokal”(Komunat) si dhe mundësitë afariste dhe ambienti ekzistues biznesor i tyre, në funksion të themelimit (regjistrimit) dhe funksionimit të suksesshëm të Subjekteve të Vogla dhe të Mesme, në bazë të praktikës pozitive të shteteve më të zhvilluara, kandidatja ka potencuar faktin që edhe në Kosovë ka filluar të aplikohet i a.q. Indeksi i Konkurrencës në Komunat e Kosovës (IKK), i cili shërben si mjet për matjen e cilësisës së funksionimit dhe qeverisjes së institucioneve lokale. IKK-ja, në realitet, paraqet një raport vjetor i hulumtimeve të sferave të ndryshme që tregon Komunitetin e Biznesit, në njërën anë, dhe shërbimet, mundësitë, obligimet, ambientin e krijuar biznesor si dhe format e ndryshme efikase të komunikimit me Institucionet Lokale (Komunat). Përmes këtij “Indeksi i Konkurrencës së Komunave” (IKK) në Kosovë, matet ambienti biznesor në Kosovë prej vitit 2011 në nivel të komunave, duke i analizuar pyetjet se cilat janë ato performanca më të mira që duhet t’i posedojë një “Komunë Referente” për një qeverisje sa më të suksesshme lokale. Në këtë funksion, kandidatja, i ka parashtruar renditjet dhe rezultatet e “Tetë (8) Nënindekseve të Mjedisit Biznesor Komunal”.

Dhe, në kuadër të pjesës së veçantë, që edhe asocon në përfundimin e punimit, kuptohet, sipas suksesivitetit të punimit, vjenë pjesa e **“Përfundimit me Konkluzat”** që, qartë fletë për një pjesë të punimit që ka karakterin sublimativ dhe, brenda së cilës, kandidatja e doktoraturës-**Shpresa Bajrami**, ka nxjerrë konkluzat përkatëse, të cilat mund të shfrytëzohen nga ana e institucioneve të interesuarë por, edhe nga ana e individëve me kualifikime përkatëse, sipërmarrësve të rinj, menaxherëve të subjekteve të vogla dhe të mesme afariste etj., gjitha këto në funksion të realizimit të objektivave të tyre përkatëse hulumtuese-shkencore.

Dhe, në fund, nga ana e kandidatës, është prezantuar **“Literatura”** e cila, në mënyrë direkte apo indirekte, tregon problematikën e hulumtuar dhe ka zbegatuar përmbajtjen e punimit.

### **PËRFUNDIM me PROPOZIM**

Në bazë të asaj që është prezantuar më lartë, komisioni konstaton se punimi me titull **“Roli ekonomik i NVM-ve nëpër komunat si parakusht për zhvillimin e përsheptuar socio-ekonomik të Republikës së Kosovës”** i punuar nga kandidatja M-r. Sc. Shpresa Bajrami, sipas esencës së saj, vëllimit, mënyrës së përpunimit, interpretimit të rezultateve dhe përfundimit, paraqet një punim i mëvetësuar hulumtues-shkencor i cili plotëson kushtet, standardet dhe kriteret e nevojshme në përputhje me rreguloren për studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës.

Komisioni, në mënyrë pozitive, vlerëson punimin e doktoraturës dhe i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik që të aprovoj këtë raport si dhe t,i mundësoj kandidatës për doktoraturë- **Mr. Shpresa Bajrami** në mënyrë publike, para Komisionit 5-anëtarësh ta prezantoj dhe ta mbrojë punimin e sajë të doktoraturës me titull “ **Roli ekonomik i NVM-ve nëpër komunat si parakusht për zhvillimin e përshpejtuar socio-ekonomik të Republikës së Kosovës**”

**ANËTARËT E KOMISIONIT :**

1. Prof. Dr. Raman Ismaili-kryetar,



2. Prof Dr. Sali Zhaku-anëtar.

3. Prof.Dr. Ibish Mazreku-anëtar,

4. Prof.Dr. Brikend Aziri-anëtar,



5. Prof.Dr.Naser Raimi-mentor-



Komisioni, në mënyrë pozitive, vlerëson punimin e doktoraturës dhe i propozon Këshillit Mesimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik që të aprovoj këtë raport si dhe t'i mundësoj kandidatës për doktoraturë- Mr. Shpresa Bajrami në mënyrë publike, para Komisionit 5-anëtarësh ta prezantoj dhe ta mbrojë punimin e sajë të doktoraturës me titull " Roli ekonomik i NVM-ve nëpër komunat si parakusht për zhvillimin e përshpejtuar socio-ekonomik të Republikës së Kosovës"

#### ANËTARËT E KOMISIONIT:

1. Prof. Dr. Raman Ismaili-kryetar,

2. Prof Dr. Sali Zhaku-anëtar.

3. Prof.Dr. Ibish Mazreku-anëtar,

4. Prof.Dr. Brikend Aziri-anëtar,

5. Prof.Dr.Naser Raimi-mentor.

The image shows five handwritten signatures in black ink, each corresponding to one of the names listed in the list above. The signatures are written in a cursive style. The first signature is for Prof. Dr. Raman Ismaili, the second for Prof. Dr. Sali Zhaku, the third for Prof. Dr. Ibish Mazreku, the fourth for Prof. Dr. Brikend Aziri, and the fifth for Prof. Dr. Naser Raimi.